



Metoda Kërkimi

Prof. Asoc. Dr. Ezmolda Barolli



Kapitulli 5

Dizenjimi i kërkimit



Objektivat

- Të kuptoni rëndësinë e dizenjimit të kërkimit
- Të identifikoni strategjitë e kërkimit
- Të shpjegoni ndryshimet e teknikave cilësore dhe sasiore të mbledhjes dhe analizimit të të dhënave
- Të shpjegoni avantazhet e adoptimit të metodave të shumëfishta të realizimit të kërkimit
- Të kuptoni çfarë rrjedhojash ka adoptimi i shtrirjeve kohore të ndryshme për dizenjimit të kërkimit
- Të shpjegoni kuptimin e vlefshmërisë dhe besueshmërisë së rezultateve dhe të dini çfarë mund ti dëmtojë ato
- Të kuptoni disa nga çështjet e etikës që varen nga strategjia që keni zgjedhur




Përmbajtja

1. **Hyrje**
2. **Qëllimi i kërkimit**
3. **Strategjia e kërkimit**
4. **Kombinimi i teknikave dhe procedurave sasimore dhe cilësore**
5. **Shtrirja kohore**
6. **Besueshmëria e rezultateve të kërkimit**
7. **Etika e dizenjimit të kërkimit**
8. **Përmbledhje**

1. Hyrje

Struktura “qepë” e kërkimit





Hyrje

- **Dizenjimi i kërkimit do të jetë plani i përgjithshëm me anë të të cilit mendoni ti përgjigjeni pyetjeve të kërkimit dhe të realizoni objektivat.**
- **Duhet të bëni një dallim midis:**
 - **Dizenjimit**
 - Plani i përgjithshëm i kërkimit
 - **Taktikës**
 - Detajet e mbledhjes së të dhënave dhe analizimit të tyre



2. Qëllimi i kërkimit

Studim

- Eksplorues
- Përshkrues
- Shpjegues

Megjithatë në varësi të pyetjeve që keni ngritur në fillim kërkimi shkencor mund të ketë më shumë se një qëllim të vetëm

- Përgjigjet mund të rezultojnë:
 - Përshkruese
 - Përshkruese dhe shpjeguese
 - Shpjeguese



Qëllimi i studimit

○ Eksplorues

- Të zbulohet “çfarë po ndodh” të bëhen pyetje për të vlerësuar fenomenet nën një këndvështrim të ri.
- Karakterizohet nga fleksibiliteti.
- Ka tre mënyra kryesore për të bërë një kërkim të tillë:
 - Kërkim në literaturë, Intervista me ekspertë, Intervista me grupe të fokusuara

○ Përshekruues

- Të portretizojë profilin aktual të personave, fenomeneve, ngjarjeve ose situatave që po studiohen.
- Pararendës ose pjesë e studimeve eksploruese ose shpjeguese.
- Fotografi të qartë të situatës apo fenomeneve përpara se të mblidhen të dhënat dhe të analizohen.

○ Shpjegues

- Studimet që përcaktojnë relacionet shkakësore midis variablave.
- Qëllimi këtu është të studiohen fenomenet ose problemet në mënyrë që të shpjegohen relacionet midis variablave.



3. Strategjia e kërkimit

- Eksperimenti
- Studimet (Survey)
- Studimi i rastit
- Kërkimi në veprim (Action research)
- Teoria e bazuar (Grounded theory)
- Etnografia
- Kërkimi në arshiva
- *Zgjedhja e strategjisë do të udhëhiqet nga pyetjet e kërkimit dhe objektivat, shtrirja e njohurive tuaja, sasia e kohës dhe burimeve të tjera që keni në dispozicion, si dhe filozofia juaj e kërkimit.*



Eksperimenti

- **Forma klasike e kërkimeve në shkencat e natyrës.**
- **Qëllimi është të studiojë lidhjet shkakësore.**
- **Ndryshimi në një variabël të pavarur të sjellë ndryshime në variablat e varura.**
- **Përfshin**
 - Përcaktimin e hipotezave teorike
 - Përzgjedhjen e kampionit nga një popullatë e njohur
 - Përzgjedhjen e kampionit në mënyrë të rastësishme
 - Matjen e një numri të vogël variablash të varura
 - Kontrollin e variablave të tjera



Survey (studimet)

- Zakonisht shoqërohet me metodën deduktive.
- Qëllimi është ti përgjigjet pyetjeve “kush, çfarë, ku, si, sa?”.
- Përdoret në kërkimet eksploruese dhe përshkruese.
- Karakteristikat
 - Popullor për kërkimin në biznes dhe menaxhim
 - Perceptohet si i besueshëm
 - Mbledhje e të dhënave sasiore
 - Kampioni duhet të jetë përfaqësues
 - I jep pavarësi kërkuesit
 - Përdoren intervista dhe observime të strukturuar dhe pyetsorë

Studimi i rastit

- Përfshin investigimin e një fenomeni brenda kontekstit të jetës së tij reale duke përdorur burime të shumëfishta evidencash.
- Qëllimi është ti përgjigjet pyetjeve “pse?” sikurse edhe “çfarë, si?”.
- Përdoret në kërkimet eksploruese dhe shpjeguese.
- Të dhëna sasiore dhe cilësore nëpërmjet pyetsorëve dhe intervistave gjysëm të strukturuar
- Katër strategji studim rasti bazuar në dy dimensionë:
 - Studim rasti i vetëm v. Studim rasti i shumfishtë
 - Studim rasti holistik v. Studim rasti i ndërfutur



Kërkimi në veprim (Action research)

- **Karakteristikat**

- Kërkim në veprim
- Përfshin në kërkim edhe punonjësit
- Kërkuesi bëhet pjesë e organizatës
- Promovon ndryshimin në organizatë
- I përgjigjet pyetjeve “Si?”.
- Ka dy fokuse: atë të kërkuesit dhe atë të sponsorit



Teoria e bazuar (grounded theory)

○ Karakteristikat

- Shembulli më i mirë i metodës induktive.
- Megjithatë mund të konsiderohet si strategjia për “ndërtimin e teorisë” nëpërmjet metodës induktive dhe deduktive.
- Përdoret për të predikuar dhe shpjeguar sjelljen.
- Mbledhja e të dhënave fillon pa pasur një kuadër teorik fillestar.
- Teoria zhvillohet nga të dhënat e gjeneruara nga observimet.
- Të dhënat na çojnë drejt predikimeve të cilat testohen me observime të tjera.



Etnografia

- **Karakteristikat**

- I ka bazat tek metoda induktive.
- Ka qëllim të përshkruajë dhe shpjegojë botën sociale të banuar nga vetë kërkuesi
- Ndërmerret në një periudhë kohe të gjatë
- Është një strategji natyrale
- Përfshin observime të zgjeruara të pjesmarrësve.
- Nuk është një metodë e zakonshme e kërkimit në biznes
- Kërkon një besim dhe pjesmarrje të gjërë të nga pjesmarrësit në kërkim dhe bashkëpunim me ta.




Kërkimi në arshiva

○ Karakteristikat

- Burimi kryesor i të dhënave janë dokumentat dhe rekordet administrative.
- Pyetjet e kërkimit të fokusuara në të shkuarën.
- Studimi mund të jetë eksplorues, përshkruues ose shpjegues.
- Është i kushtëzuar nga natyra e rekordeve dhe dokumentave.
- Jo gjithmonë është e mundur të gjendet informacioni i saktë.

4. Kombinimi i teknikave dhe procedurave





Avantazhet dhe disavantazhet

- **Avantazhet**

- Teknika të ndryshme mund të përdoren për qëllime të ndryshme në studim
- Mundëson “Triangulation”. Dmth përdorimin e disa teknikave për të provuar vërtetësinë e të dhënave.

- **Disavantazhet**

- Rezultatet do të ndikohen patjetër nga teknika e mbledhjes së të dhënave dhe procedura e analizimit.
- Kjo quhet “efekti i metodës” .
- Për ta shmangur përdoren teknika të ndryshme që të zerohet pikërisht ky efekt.

5. Shtrirja kohore

- **Cross-sectional study (fotografi e një momenti)**
 - Studimi i një fenomeni të caktuar në një kohë të caktuar
 - Përdorin strategjinë e survey me pyetsor ose intervistat.
- **Longitudinal study (paraqitje e ngjarjeve në një periudhë të caktuar)**
 - Kohëzgjatja e lejon të studiojë ndryshimet e mundëshme dhe zhvillimin.
 - Kërkuesi provon që variablat nuk ndikohen nga procesi meqë ato testohen në një periudhë të gjatë kohe.
 - Edhe në mungesë të kohës mund të ndërmerret një kërkim i tillë duke studiuar rezultate të disa survey të mëparshëm.

6. Besueshmëria e rezultateve

Theksi duhet të vendoset mbi besueshmërinë dhe vlefshmërinë e rezultateve.

- Besueshmëria – shkalla në të cilën teknikat e mbledhjes së të dhënave dhe analizimit ju japin rezultate konsistente.
 - Do të na jepnin matjet të njëjtat rezultate në një rast tjetër?
 - Do të arriheshin të njëjtat observime nga observues të tjerë?
 - A ka transparencë tek të dhënat bruto?
- Cënimi i besueshmërisë
 - Gabimi i subjektit
 - Ndikimi i subjektit
 - Gabimi i observuesit
 - Ndikimi i observuesit

Besueshmëria e rezultateve

- **Vlefshmëria**

- A kanë të njëjtën vlerë rezultatet me atë që duket?
- A kanë një lidhje shkakësore variablat?

- **Cënimi i vlefshmërisë**

- **Historia** – kur kërkimi nuk ndërmerret në periudhën e duhur.
- **Testimi** – kur pjesmarrësi mendon se pjesmarrja në test do ti ndikojë për keq atij
- **Instrumentimi** – kur pjesmarrësit ndikohen nga ndonjë instruksion tjetër jashtë kërkimit tuaj dhe e ndikojnë edhe atë.
- **Mortaliteti** – kur pjesmarrësit e braktisin studimin
- **Maturimi** – kur ngjarje të tjera e ndikojnë procesin që ju po shqyrtoni.
- **Dyktuptimësia e drejtimit shkakësor** – kur nuk e kuptojmë cili është shkak dhe cila pasoja (drejtimin)



Përgjithësimi

- **Vlefshmëria e jashtëme**
 - Sa kanë mundësi të përgjithësohen rezultatet?
 - A kanë të njëjtën vlerë dhe a janë të aplikueshme dhe në organizata të tjera?
- **Cënimi**
 - Studimi i rastit
 - Kur qëllimi është të shohim çfarë po ndodh në një rat të veçantë.

Hapat logjikë dhe supozimet false

- **Popullata**

- A është zgjedhja e popullatës logjike sidomos nëse do të bëhen përgjithësime.

- **Mbledhja e të dhënave**

- A është logjike mbledhja e të dhënave. A i jeni drejtuar personave të duhur për intervista psh?

- **Keqinterpretimi i të dhënave**

- Ka më shumë mundësi të ndodhë kur jeni duke punuar nga teoria tek të dhënat (deduktive) atëherë përdorini kuadrin teorik për të analizuar të dhënat. Ky kuadër ka mundësuar ngritjen e hipotezave të cilat i testoni.

- **Zhvillimi i konkluzioneve**

- A janë konkluzionet logjike apo po i kërkohet lexuesit të bëjë lidhjen logjike të gjërave?



7. Etika e dizenjimit të kërimit

- **Të konsiderohen**

- Çështjet etike që nuk çënojnë popullatën në vëzhgim
- Shkalla në të cilën mblidhen të dhënat për një popullatë që nuk e di se po vëzhgohet
- ‘Dizenjimi i kërimit nuk duhet të turpërojë, të dëmtojë apo ti shkaktojë disavantazhe materiale popullatës në vëzhgim’



8. Përmbledhje

- **Dizenjimi i kërimit i kthen pyetjet dhe objektivat e kërimit në një projekt që merr në konsideratë:**
 - Strategjitë, zgjedhjen e teknikave, shtrirjen kohore
- **Projektet e kërimit kategorizohen në:**
 - Eksplorues, përshkrues, shpjegues
- **Projektet e kërimit mund të jenë:**
 - Cross-sectional, Longitudinal
- **Çështje që duhen konsideruar**
 - Disa strategji mund të kombinohen në një studim
 - Ka avantazhe në përdorimin e metodave të shumëfishta
 - Vlefshmëria dhe besueshmëria e rezultateve
 - Çështjet e aksesit dhe etikës